

---

# Institucionalizimi i Punës Rinore në Shqipëri

DOKUMENT POLITIK



KONGRESI  
RINOR  
KOMBËTAR



tirana  
EUROPEAN  
YOUTH  
CAPITAL'22



BASHKIA  
TIRANË

**Publikuar nga:**

**Organizata Përtej Barrierave**

Rruga Don Bosko, Pallati Gener 2, Kati 6, H 47 Tiranë  
[www.beyondbarriers.org](http://www.beyondbarriers.org) / [www.aktivizon.al](http://www.aktivizon.al)

**Kongresi Rinor Kombëtar**

Rr. Abdyl Frashëri, Pall. 1, Shkalla 5, Kati 3, Ap. 40, Tiranë - Shqipëri  
[www.krk.al](http://www.krk.al) / [www.tiranaeyc2022.al](http://www.tiranaeyc2022.al)

Ky publikim është realizuar nga Përtej Barrierave dhe Kongresi Rinor Kombëtar në kuadër të programit Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022, me mbështetjen financiare të Bashkisë Tiranë dhe Kongresit Rinor Kombëtar.

Mendimet dhe opinionet e shprehura në të u përkasin autorëve realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.



**KONGRESI  
RINOR  
KOMBËTAR**



**tirana**  
EUROPEAN  
YOUTH  
CAPITAL '22



**BASHKIA  
TIRANË**

# PËRMBARTJA

01.

Qëllimi

02.

Shpjegime konceptuale

03.

Situata Aktuale dhe  
problematika

04.

Mesazhet Kryesore dhe  
Rekomandimet

05.

Konkluzione

# 01. QËLLIMI

**Organizata Përtej Barrierave (PB) dhe Kongresi Rinor Kombëtar (KRK) janë të përkushtuara në promovimin dhe fuqizimin e praktikës së punës rinore në Shqipëri.**

Nëpërmjet një studimi kombëtar të realizuar në kuadër të programit Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022 me mbështetjen financiare të Bashkisë Tiranë dhe KRK, janë identifikuar nevojat për institucionalizimin dhe njohjen e punës rinore në Shqipëri.[1]

Bazuar në gjetjet e këtij studimi dhe vizionin që kemi lidhur me praktikën e punës rinore, adresojmë këtë Dokument Politik me qëllim paraqitjen e rekomandimeve për: **krijimin e një mjedisi institucional që njeh vlerën e shtuar që ka Puna Rinore dhe ndikimin e saj socio-ekonomik në Shqipëri, duke e institucionalizuar dhe njohur këtë praktikë.**

[1] Përtej Barrierave, Kongresi Rinor Kombëtar (2023) 'Dimensione rinore: potenciali dhe zhvillimi i punës rinore në Shqipëri, studim kombëtar mbi punë rinore', Tiranë

## 02. SHPJEGIME KONCEPTUALE

Me institucionalizim të punës rinore kuptojmë **zhvillimin e kuadrit rregullator për njohjen e kësaj praktike dhe profesionit të punonjësit rinor, përcaktimin e standardeve për sigurimin e cilësisë, krijimin e mundësive për formim jo formal apo/dhe formal për zhvillimin profesional të punonjësve rinorë, njohjen e kompetencave të fituara nëpërmjet edukimit jo formal.** Gjithashtu kuptojmë **konsolidimin e bashkëpunimit midis organizatave të shoqërisë civile apo/dhe institucioneve të tjera publike dhe jo publike për të siguruar cilësinë në ofrimin e shërbimeve për të rinjtë nga punonjësit rinorë.**

Institucionalizimi i punës rinore do të ofronte një qasje të strukturuar dhe të organizuar për të mbështetur zhvillimin pozitiv të të rinjve, duke promovuar bashkëpunim më të madh midis organizatave rinore dhe për të rinjtë, individëve dhe institucioneve publike që punojnë në këtë fushë.

Për përkufizimin e Punës Rinore referojmë përkufizimin e gjerë të bërë në ligjin nr. 75/2019 'Për Rininë' si **"çdo veprimtari e natyrës sociale, kulturore, arsimore, mjedisore nga/me ose për të rinjtë, në grupe ose individualisht, që ka për qëllim të motivojë dhe të mbështesë të rinjtë, duke kontribuar në zhvillimin e tyre personal dhe social dhe në zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi"**.

Për sa i përket punonjësit rinor (zbatuesi i punës rinore), duke qenë se mungon përkufizimi në kuadër ligjor, është deduktuar përkufizimi se **punonjës rinor është zbatues i punës rinore që "ofron mbështetje dhe orientim për të rinjtë në një sërë fushash, përfshirë arsimin, karrierën, jetën sociale, kulturore, mjedisore dhe më shumë duke kontribuar në zhvillimin e tyre personal dhe social dhe në zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi."**[2]

[2] Përkufizim i ofruar nga ekspertët e studimit 'Dimensione rinore: potenciali dhe zhvillimi i punës rinore në Shqipëri, studim kombëtar mbi punë rinore', Tiranë

Për të plotësuar hendekun konceptual në Shqipëri për punonjësin rinor, dakordësojmë që të përdoret përdorim koncepti i referuar nga KE i 'Komunitetit të praktikës' bazuar në kuptimin e përgjithshëm të konceptit teorik zhvilluar nga psikologët Jean Lave dhe Étienne Wenger: 'Komunitetet e praktikës janë grupe njerëzish që ndajnë një shqetësim ose një pasion për diçka që bëjnë dhe mësojnë si ta bëjnë më mirë ndërsa bashkëveprojnë rregullisht'. [3]

## 03. SITUATA AKTUALE DHE PROBLEMATIKA

### Perceptimi i të intervistuarve dhe të anketuarve në studimin kombëtar

Puna rinore është një praktikë që ofron hapësirë dhe mundësi për të rinjtë për tu fuqizuar dhe për të qenë qytetarë aktiv të shoqërisë, duke mbështetur zhvillimin personal dhe social të tyre. Në Shqipëri nuk ka kuadër rregullator të dedikuar për punën rinore dhe praktikën e saj. **Mosnjohja si profesion e përball këtë praktikë me shumë sfida të tjera si mungesa e klasifikimit në fusha interesi, specializimit të punonjësve që punojnë me të rinjtë, mungesa e të dhënave cilësore në fushë, apo dhe aspekte të promovimit dhe vlerave që kjo praktikë mbart. Mosnjohja e rolit të punonjësit rinor si profesion, sjell mungesën e alternativave për një karrierë afatgjatë dhe të konsoliduar, apo nuk stimulon hapjen e programeve studimore rinore, në institucionet e arsimit të lartë, të cilat do të ndikonin në rritjen e cilësisë në këtë praktikë.**

Ligji nr. 75/2019 "Për Rininë" paraqet një përkufizim të përgjithshëm kombëtar të punës rinore si "çdo veprimtari e natyrës sociale, kulturore, arsimore, mjedisore nga/me ose për të rinjtë, në grupe ose individualisht, që ka për qëllim të motivojë dhe të mbështesë të rinjtë, duke kontribuar në zhvillimin e tyre personal dhe social dhe në zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi". Po ashtu në këtë ligj përskruhet mënyra se si puna rinore

[3] Wenger, Etienne (c 2007) 'Communities of practice. A brief introduction'. Communities of practice.

realizohet duke specifikuar angazhimin dhe aktivizimin e të rinjve në veprimtari që reflektojnë nevojat, interesat, idetë dhe eksperiencat e tyre. Në këtë përkufizim sillet dhe koncepti i të nxënës joformal, proces nëpërmjet të cilit të rinjtë fitojnë njohuri, aftësi, vlera dhe qëndrime që nevojiten për zhvillimin personal, integrimin social dhe qytetarinë aktive.

Disa nga konceptet e tjera të rëndësishme që ky ligj prezanton, të cilat lidhen përmbajtësisht me zbatimin e punës rinore është dhe edukimi joformal për të rinjtë. Në edukimin joformal për të rinjtë përfshihet çdo veprimtari e organizuar dhe e përshtatur për të rinjtë, jashtë sistemit formal të arsimit, i bazuar në nevojat dhe interesat e të rinjve, parimet e vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes aktive të të rinjve në proceset e të nxënës, nëpërmjet të cilit fitojnë kompetenca të nevojshme për zhvillimin e potencialit personal, pjesëmarrjes aktive në shoqëri dhe aksesit në tregun e punës.

**Pavarësisht se përbën risi, përkufizimi i konceptit të “punës rinore”, si realizohet ajo dhe marrëdhënia që ka me të edukimi joformal, në ligjin 75/2019 nuk artikulohej atributet thelbësore të punës rinore, nuk e diferencohet puna rinore nga disiplinat e tjera që gjithashtu kontribuojnë ose punojnë me të rinjtë apo kuadër rregullator mbi monitorimin e punës rinore apo nuk është rregulluar profesioni i punonjësit rinor i diferencuar nga profesione të tjera duke specifikuar përshtatje të aftësive/kompetencave që duhet të ketë.**

Për sa i përket kësaj të fundit, në **Listën Kombëtare të Profesioneve (LKP) rishikuar në vitin 2017 është shtuar punësimi me kod 3412.27: “Punonjës rinie”** i cili listohet në grup-njësine (Profesionin) **“Asistentë, specialistë të punës sociale”**. Gjithsesi, do të takonte autoriteteve përkatëse të përcaktojnë nëse një mundësi specifike punësimi plotëson kriteret e përcaktuara në ligj dhe aktualisht mungon kuadri ligjor që e rregullon këtë punësim/profesion. [4]

Në Strategjinë Kombëtare për Rininë 2022–2029, i cili është dokumenti bazë për politikën rinore janë parashikuar disa masa të cilat targetojnë punën rinore apo elementë të lidhur me këtë praktikë.

[4] Vendim nr. 514, Datë 20.9.2017 ‘Për Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të Rishikuar.

**Masa e parë parashikon që brenda vitit 2024 të realizohet rishikim i Ligjit për Rininë duke pasur në konsideratë konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të disa proceseve si ato lidhur me: krijimin e organizatave rinore, përfaqësimin rinor, ofrimin e shërbimeve të pranueshme e miqësore për të rinjtë dhe punën rinore. Për sa i përket kuadrit ligjor që prek sektorin e rinisë është parashikuar edhe rishikimi i ligjit “Për Vullnetarizmin” brenda vitit 2023 me qëllim fuqizimin e mundësive për vullnetarizmin e të rejave/rinjve.**

Në Strategji parashikohet dhe marrja e masave institucionale për njohjen e kompetencave të fituara nëpërmjet edukimit jo formal dhe punës rinore bazuar në përcaktimet e profesioneve të punës së të rinjve nëpërmjet Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe klasifikimit të profesioneve (European Youth Work Portfolio), në përputhje me ligjet dhe VKM-të për njohjen e përvojës së punës dhe mësimin informal dhe joformal. [5]

### **Perceptimi i të intervistuarve dhe të anketuarve në studimin kombëtar**

**Njohja si profesion e zbatimit të punës rinore konsiderohet si nevoja më e rëndësishme nga 67.9% e pjesëmarrësve në studimin kombëtar.** Edhe pse profesioni “punonjës rinor” nuk është i rregulluar/standardizuar, gjithsesi bazuar në perceptimin e të intervistuarve dhe atyre që janë përgjigjur në pyetësor, **66.1% shprehen se mund të zhvillohet karrierë si punonjës rinor në Shqipëri, 21.4% nuk janë të sigurt dhe 10.7% mendojnë që nuk mund të zhvillohet.**

Në lidhje me **pengesat që hasin gjatë praktikës së punës rinore**, punonjës të rinorë pjesëmarrës në studim deklarojnë si më kryesoren **mungesën e fondeve për zhvillimin e aktiviteteve (57.1%)** duke vijuar me **mungesën e mundësive për trajnime/rritje e kapaciteteve në këtë fushë (30.4%)**, faktin që **puna rinore nuk njihet zyrtarisht nga institucionet (23.2%)**, mos vlerësimi i **aktivitetit dhe kontributit të punonjësve rinorë në komunitet (10.7%)**. **Një element që theksohet nga të intervistuarit është mungesa e politikave të mirëfillta të cilat nxisin, promovojnë dhe mbështesin punën rinore në komunitet.** Janë këto politika të cilat duhet të bëjnë një përpjekje të koordinuar në nivel kombëtar për rritjen e cilësisë së punës rinore dhe vendosjen e standardeve për zbatimin e saj.

[5] Vendim nr. 692, datë 26.10.2022 ‘Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe Planit të Veprimit 2022–2029’



Studimi konstaton se **pjesa më e madhe e punonjësve rinorë 62.5% ushtrojnë veprimtarinë si punonjës rinorë në organizata rinore/për të rinj.** Organizatat nuk përdorin metoda/teknika apo udhëzues për sigurimin e cilësisë së punës rinore, si dhe kanë zhvilluar kapacitetet e punonjësve rinorë përmes aktiviteteve joformale, përfshirjes në eksperiencë pune vullnetare, rritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar (menaxhimi i projekteve, aftësitë e komunikimit, të mësuarit ndërkulturor, menaxhimin organizacional, mbledhjen e fondeve, etj.). **Si rrjedhojë, duke qenë se OSHC-të mbajnë pozicion kyç si ofrues kryesorë të punës rinore, nevoja për profesionalizëm, standardizim, sigurim të cilësisë brenda Organizatave të Shoqërisë Civile konsiderohet po ashtu si domosdoshmëri.**

Sipas të intervistuarve **puna rinore e ofruar nga institucionet vendore fokusohet kryesisht në zhvillimin e aktiviteteve dhe rritjes së kapaciteteve të të rinjve përmes trajnimeve dhe seminareve por që kryesisht nuk janë ndërhyrje të vazhdueshme.** Në nivel lokal ka një përpjekje për të mbështetur të rinjtë përmes zhvillimit të aktiviteteve dhe rritjes së kapaciteteve përmes trajnimeve dhe seminareve por që kryesisht nuk janë ndërhyrje të vazhdueshme dhe nuk mbështeten në plane lokale veprimi për rininë. **Duke qenë se nuk ka një qartësim nga pikëpamja ligjore të punonjësit rinor, bashkitë e gjejnë të vështirë që të kuptojnë rolin detyrat dhe të zhvillojnë infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e punës rinore.** [6]

[6] Përkufizim i ofruar nga ekspertët e studimit 'Dimensione rinore: potenciali dhe zhvillimi i punës rinore në Shqipëri, studim kombëtar mbi punë rinore', Tiranë

# 04. MESAZHET KRYESORE DHE REKOMANDIMET

Organizata Përtej Barrierave dhe Kongresi Rinor Kombëtar rekomandojnë veprimet e mëposhtme për të institucionalizuar punën rinore në Shqipëri:

## Drejtuar Qeverisë Shqiptare dhe institucioneve publike

01

Të rishikohet Ligji 'Për Rininë' sipas planifikimit të bërë në Strategjinë Kombëtare për Rininë 2022-2029, me fokus rregullimin e mëtejshëm të praktikës së punës rinore. Të konsolidohet në tërësi kuadri ligjor/rregullator për institucionalizimin e punës rinore, njohjen/standardizimin e profesionit dhe kompetencat që duhet të ketë punonjësi rinor dhe sigurimin e cilësisë. Ky kuadër duhet të përfshijë edhe kodin e etikës për punonjësit rinorë, udhëzime për formimin dhe kualifikimin si dhe sistemin e monitorimit nga institucionet publike përkatëse për sigurimin e cilësisë.

02

Organizatat e shoqërisë civile ofruese të punës rinore, të konsiderohen si aktorë kyç nga institucionet qendrore dhe vendore gjë e cila do të ndihmonte për të krijuar një mjedis që orientohet nga interesi për shërbime rinore cilësore. Këto organizata duhet të jenë aktorë aktivë në procesin e amendimit të ligjit 'Për rininë' si dhe tërësisë së kuadrit ligjor rregullator që institucionalizon këtë praktikë, duke vlerësuar ekspertizën disa vjeçare në praktikën e punës rinore se tyre.

03

Të merren masat institucionale për njohjen e kompetencave të fituara nëpërmjet edukimit jo formal dhe punës rinore bazuar në përcaktimet e profesioneve të punës së të rinjve nëpërmjet Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe klasifikimit të profesioneve (European Youth Work Portfolio), në përputhje me ligjet dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave për njohjen e përvojës së punës dhe mësimin informal dhe joformal. Ky proces është në mbështetje të qëllimit për konsolidimin e praktikës së punës rinore në Shqipëri.

04

Të fuqizohen kapacitetet e nëpunësve civilë në fushën e rinisë dhe zbatimin e politikave rinore bazuar në konceptin e shërbimeve miqësore dhe të pranueshme nga të rejtat dhe të rinjtë. Por duhet të theksohet se marrëdhëniet juridike të nëpunësve civil të NJVV-ve rregullohen nga Kuadri ligjor për nëpunësin civil. Punësimi i këtij stafi, si përshembull në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të cilat e kanë detyrim të kenë struktura që mbulojnë çështjet e rinisë, të kenë formim apo të vijnë nga sektori i punës me rininë dhe të mundësojnë ofrimin e shërbimeve të drejtpërdrejta për të rinjtë.

05

Të mbështetet hapja e programeve me fokus studimet rinore apo/dhe formimin e punonjësve rinorë në institucionet e arsimit të lartë publik. Studimet e dedikuara për rininë do të rrisin ndjeshëm studimin e nevojave të sektorit dhe në cilësinë e formimit të punonjësve rinorë duke ofruar mundësi për të rinjtë që të mësojnë dhe të angazhohen në praktikën e punës me të rinjtë.

06

Të krijohet një bazë të dhënash kombëtare të ofruesve të punës rinore duke përfshirë organizatat qeveritare dhe joqeveritare. Kjo bazë të dhënash duhet të jetë e aksesueshme për publikun dhe të përfshijë informacion mbi llojet e shërbimeve të ofruara, grupet e synuara dhe mbulimin gjeografik.

07

Të sigurohen fonde për konsolidimin e punës rinore dhe formimin e punonjësive rinore për të mbështetur qëndrueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve të punës rinore. Ky financim duhet të ndahet përmes një procesi konkurrues dhe bazuar në cilësinë e propozimeve dhe nevojat e grupeve të synuara.

## Drejtuar organizatave të shoqërisë civile, si komuniteti i praktikës

01

Të kontribuojnë në konsolidimin e komunitetit të punonjësve rinorë duke lobuar për institucionalizimin dhe njohjen e këtij profesioni me institucionet publike bazuar në ekspertizën disa vjeçare në praktikën e punës rinore, si dhe duke sjellë praktika ndërkombëtare të suksesshme të punës rinore.

02

Të rritet komunikimi brenda sektorit rinor duke nxitur angazhimin e komunitetit të punonjësve rinorë në të mësuarit e përbashkët me homologët e tyre, shkëmbimin e praktikave të përbashkëta dhe përvojave të të nxënit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

## 05. KONKLUZIONE



**Organizata Përtej Barrierave dhe Kongresi Rinor Kombëtar** besojnë se institucionalizimi dhe njohja e punës rinore në Shqipëri janë thelbësore për rritjen e cilësisë në ofrimin e shërbimeve rinore me qëllim nxitjen e zhvillimit personal dhe social të të rinjve. Në këtë kuadër rekomandojmë zhvillimin e një plani të mirëfilltë pune nga institucionet përgjegjëse publike për fushën e rinisë për ndërmarrjen e masave, në bashkëpunim me aktorët e tjerë social si organizatat rinore dhe për rininë për: hartimin e kuadrit rregullator për punën rinore, njohjen e kompetencave të fituara nëpërmjet edukimit jo formal dhe punës rinore, integrimin e punës rinore në programet e arsimit formal, fuqizimin e kapaciteteve të nëpunësve civilë në fushën e rinisë, e të tjera.

**Ne jemi të përkushtuar të punojmë me institucionet publike dhe aktorë të tjerë për të promovuar dhe kontribuar në institucionalizimin e punës rinore në Shqipëri.**

# 06. BIBLIOGRAFIA

- Ligji nr. 75/2019 'Për Rininë'
- Përtej Barrierave dhe Kongresi Rinor Kombëtar (2023) 'Dimensione rinore: potenciali dhe zhvillimi i punës rinore në Shqipëri, studim kombëtar mbi punë rinore', Tiranë
- Vendim nr. 514, Datë 20.9.2017 'Për Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të Rishikuar.
- Vendim nr. 692, datë 26.10.2022 'Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe Planit të Veprimit 2022–2029'
- Wenger, Etienne (c 2007) 'Communities of practice. A brief introduction'. Communities of practice [<http://www.wenger.com/theory/>].

